

V E N D I M
Nr.94, datë 26.2.1997

PËR SRTUKTURËN DHE ORGANIKËN E ZYRËS QENDRORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

Mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.469, datë 14.8.1995 "Për kompetencat për emërimin dhe largimin nga detyra të drejtorëve të drejtorive në ministri dhe institucione të tjera qendrore dhe për ndryshimet në strukturat e tyre" në ligjin nr.7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme":

1. Struktura e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të jetë sipas skemës 1 bashkëlidhur.

2. Organika e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të jetë sipas skemës 2 bashkëlidhur.

3. Numri i punonjësve të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme do të jetë gjithsej 19 vetë.

4. Numri i zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në rrethe do të jetë 37, numri i punonjësve në to do të jetë 140 vetë.


5. Efektet financiare të përballohen nga buxheti aktual i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

6. Ndryshimet në këtë strukturë duhet të shoqërohen me argumentimet përkatëse të përballimit të kostos nga kosto lokale, burime të brendshme apo nga qarkullimi i personelit nga struktura të tjera të administratës publike pranë zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

ZYRA QENDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME



ORGANIKA E ZYRËS QENDRORE TË REGJISTRIMIT
TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

KRYEREGJISTRUESI		1
Zv/ KRYEREGJISTRUESI	1	
DREJTORIA TOPOGRAFIKE		3
Drejtori	1	
Specialistë	2	
DREJTORIA JURIDIKE	2	
Drejtori	1	
Specialist	1	
DREJTORIA E POLITIKAVE TË TOKËS DHE E MARRËDHËNIEVE ME JASHTË	3	
Drejtori	1	
Specialistë	2	
DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE	9	
Drejtori	1	
SEKTORI I FINANCËS		
Përgjegjësi i sektorit të financës (Financier)	1	
Revizor		1
Arkëtare	1	
SEKTORI I SHËRBIMEVE		
Përgjegjësi i sektorit të shërbimeve	1	
Shofer	2	
Pastrues	1	
Roje	1	
PUNONJËS GJITHSEJ NË ZYRËN QENDRORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME		19
PUNONJËS GJITHSEJ TË ZYRAVE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME NË RRETHE	140	

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi